



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL**

Nr. 1126/4 Prot.

Tiranë, më 30.07.2019

**V E N D I M**

**Nr.88, datë 30.07.2019**

**PËR MIRATIMIN E RAPORTIT PËRFUNDIMTAR TË MBIKËQYRJES SË  
ADMINISTRIMIT TË SHËRBIMIT CIVIL NË INSTITUCIONIN INSPEKTORATI  
SHTETËROR I MJEDISIT, PYJEVE, UJËRAVE DHE TURIZMIT DHE  
PARALAJMËRIMIN E INSTITUCIONIT PËR TË RREGULLUAR GJENDJEN E  
LIGJSHMËRISË.**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1, 14 dhe 15, të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative”, Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, të miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të materialit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në lidhje me zbatimin e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, në institucionin Inspektorati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit, institucion në varësi të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit,

**VËREJ SE:**

Me Vendimin nr. 98, datë 3.12.2018, “Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil, në institucionin Inspektorati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit”, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, ka vendosur fillimin e mbikëqyrjes së përgjithshme në lidhje me zbatimin e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, në institucionin Inspektorati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit.

Objekti i mbikëqyrjes përfshin veprimet administrative të kryera nga njësia përgjegjëse dhe subjektet e tjera të ngarkuara me ligj, si pjesëmarrës në proceset e administrimit të shërbimit civil, prej momentit të fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i

ndryshuar e në vijim. Procesi është zhvilluar në përputhje me Programine Mbikëqyrjes nr. 877/1 prot., datë 3.12.2018, të miratuar nga Komisioneri, njoftuar institucionit me shkresën nr. 877/2 prot., datë 3.12.2018, *“Njoftim për fillimin e procesit të mbikëqyrjes së ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në institucionin Inspektorati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit”*.

Inspektorati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit, është institucion qëpërfshihet për herë të parë në skemën e administrimit të shërbimit civil, pas fillimit të efekteve juridike të ligjit nr.152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, të ndryshuar, i cili evidentohet me numër rendor 57, në lidhjen nr. 1, *“Lista e institucioneve të administratës shtetërore”*, që është pjesë e vendimit nr. 142, datë 12.3.2014, të Këshillit të Ministrave, *“Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”*, të ndryshuar.

Në përfundim të procesit të verifikimit të dokumentacionit dhe grumbullimit të të dhënave, grupi i mbikëqyrjes ka hartuar projektraportin për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil dhe ia ka dërguar për njohje subjektit të mbikëqyrur me shkresën nr. 1126 prot., datë 24.6.2019, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, *“Dërgohet projektraporti në përfundim të mbikëqyrjes në institucionin Inspektorati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit, në lidhje me administrimin e shërbimit civil”*, duke i lënë 15 ditë kohë për të paraqitur komentet e tyre në lidhje me konstatimet e evidentuara nga grupi i mbikëqyrjes.

Me shkresat nr. 1126/1 prot., datë 24.6.2019 dhe nr. 1126/2 prot., datë 24.6.2019, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, *“Dërgohet projektraporti në përfundim të mbikëqyrjes në institucionin Inspektorati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit, në lidhje me administrimin e shërbimit civil”*, projektraporti i mbikëqyrjes i është dërguar për njohje, respektivisht, Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, që është ministria nga e cila varet institucioni i mbikëqyrur dhe Departamentit të Administratës Publike, në cilësinë e njësisë përgjegjëse në këtë rast.

Në vijim të këtij procesi, me shkresën nr. 6420 prot., datë 17.7.2019, *“Observacion mbi projektraportin për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil”*, institucioni, ka kthyer pranë Komisionerit projektraportin e nënshkruar sëbashku me observacionet përkatëse në lidhje me konstatimet e grupit të mbikëqyrjes.

Observacionet e paraqitura nga institucioni, në lidhje me pretendimet se, është reaguar për parregullsitë e evidentuara gjatë procesit të mbikëqyrjes, në rastet kur ato janë shoqëruar me aktet administrative që i mbështesin ato, janë pasqyruar në raportin përfundimtar të mbikëqyrjes.

Përsa i përket parregullsive të evidentuara, për të cilat pretendohet se është reaguar, por subjekti i mbikëqyrur nuk i mbështet me akte, megjithëse një gjë e tillë i është kërkuar

institucionit në shkresën përcjellëse të projektraportit, verifikimi i përmbushjes së këtyre detyrave, në zbatim të rekomandimeve të Komisionerit, do të jetë objekt i verifikimit të mëtejshëm, në vijim të procesit të mbikëqyrjes në këtë institucion, pas miratimit të raportit përfundimtar.

Në këto rrethana, pasi shqyrtova raportin përfundimtar të mbikëqyrjes, të paraqitur për miratim nga grupi i punës, vlerësoj se duhet të miratoj përmbajtjen e tij.

### **Për këto arsye:**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, referuar Seksionit III, “Procedura hetimore”, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

### **V E N D O S A:**

1. Të miratoj raportin përfundimtar të mbikëqyrjes së përgjithshme në lidhje me administrimin e shërbimit civil në institucionin Inspektorati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit, i cili është pjesë e këtij vendimi dhe të paralajmëroj institucionin për të rregulluar situatën e paligjshmërisë në zbatimin e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, duke kërkuar zbatimin e detyrave që do të specifikohen më poshtë.
2. Departamenti i Administratës Publike, në rolin e njësisë përgjegjëse, duhet të unifikojë kategorizimin e pozicioneve të punës në shërbimin civil, në institucionet e varësisë (në rastin konkret për pozicionet e punës “Përgjegjës Sektori”, në degët rajonale) në përputhje me kërkesat e nenit 19, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Ky proces duhet të realizohet duke vlerësuar përfshirjen tyre në një prej kategorive të përcaktuara në këtë dispozitë: e lartë drejtuese, e mesme drejtuese, e ulët drejtuese dhe ekzekutive, me qëllim rritjen e transparencës si në drejtim të procesit të rekrutimit (në nivel ekzekutiv, lëvizje paralele apo ngritje në detyrë) ashtu edhe në drejtim të mënyrës së pagesës së nëpunësit civil, në përputhje me përgjegjësitë dhe detyrat që ai realizon gjatë veprimtarisë së tij.

3. Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Komunikimeve, si njësi përgjegjëse për menaxhimin e burimeve njerëzore të institucionit, të përfundojë procesin e hartimit të përshkrimeve të punës, për të gjitha pozicionet e punës pjesë e shërbimit civil, sipas rregullave dhe procedurave të përcaktuara në Vendimin nr. 142, datë 12.3.2014, të Këshillit të

Ministrave, ”Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, të ndryshuar dhe sipas orientimeve në raportin përfundimtar të mbikëqyrjes, duke e vijuar këtë proces si më poshtë:

- Të kërkojë zyrtarisht mendimin e Departamentit të Administratës Publike, për vlerësimin e ligjshmërisë së formularit të përshkrimit të punës për çdo pozicion pune në shërbimin civil, nëse është në përputhje me legjislacionin specifik të fushë sapo formatin standard të miratuar.
  - Pas marrjes së konfirmimit nga njësi përgjegjëse (DAP), të vijojë procesin me miratimin dhe nënshkrimin e përshkrimeve të punës, nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, nëndarjen përkatëse, siç parashikohet në pikën 18, shkronja “c”, të VKM nr.142, datë 12.3.2014, i ndryshuar.
  - Pas miratimit, nënshkrimit dhe dokumentimit të përshkrimeve të punës, një kopje e tyre, të bëhet pjesë e dosjes së personelit të çdo nëpunësi civil dhe një kopje të depozitohet pranë Departamentit të Administratës Publike.
4. Për rregullimin e ligjshmërisë në lidhje me aktet administrative që kanë dalë në kundërshtim me ligjin, ku disa punonjësve, u është ngarkuar si detyrë shtesë, ushtrimi përkohësisht i detyrës “Kryeinspektor”, në Degët Rajonale, kërkohet nga Kryeinspektori i ISHMPUT, që të anulohet këto akte, të evidentuara si më poshtë:
- Urdhri nr.94, datë 16.3.2018, i Kryeinspektorit, i cili ngarkon në ushtrimin e përkohshëm të detyrës “Kryeinspektor”, Dega Rajonale Tiranë, punonjës in \*\*\*\*\* , me detyrë “Inspektor”, në Sektorin e Policisë Pyjore, Dega Rajonale Tiranë.
  - Urdhri nr.454, datë 6.12.2018, i Kryeinspektorit, i cili ngarkon në ushtrimin e përkohshëm të detyrës “Kryeinspektor”, Dega Rajonale Durrës, punonjës in \*\*\*\*\* , me detyrë “Përgjegjës Sektor”, Sektorin Operacional i Inspektimit të Policisë Pyjore, në Drejtorinë e Inspektoratit të Policisë Pyjore, pranë ISHMPUT, nivel qendror.
  - Urdhri nr.336, datë 13.8.2018, i Kryeinspektorit, i cili ngarkon në ushtrimin e përkohshëm të detyrës “Kryeinspektor”, Dega Rajonale Gjirokastrë, punonjës in \*\*\*\*\* , me detyrë “Përgjegjës Sektor”, në Sektorin e Policisë Pyjore Tepelenë, Dega Rajonale Gjirokastrë.
  - Urdhri nr.60, datë 5.3.2019, i Kryeinspektorit, i cili ngarkon në ushtrimin e përkohshëm të detyrës “Kryeinspektor”, Dega Rajonale Lezhë, punonjës in \*\*\*\*\* , me detyrë “Përgjegjës Sektor”, Sektorin Lezhë, në Sektorin e Policisë Pyjore, Dega Rajonale Lezhë.
  - Urdhri nr.85, datë 18.3.2019, i Kryeinspektorit, i cili ngarkon në ushtrimin e përkohshëm të detyrës “Kryeinspektor”, Dega Rajonale Shkodër, punonjës in \*\*\*\*\* , me detyrë “Inspektor”, Sektorin Operacional i Inspektimit të Policisë

*Pyjore, në Drejtorinë e Inspektoratit të Policisë Pyjore, pranë ISHMPUT, nivel gendror.*

- Urdhri nr.213, datë 14.5.2018, i Kryeinspektorit, i cili ngarkon në ushtrimin e përkohshëm të detyrës “Kryeinspektor”, *Dega Rajonale Elbasan*, punonjës in \*\*\*\*\*, me detyrë “Inspektor”, *Spektori Librazhd, në Sektorin e Policisë Pyjore, Dega Rajonale Elbasan.*
- Urdhri nr.290, datë 3.7.2018, i Kryeinspektorit, i cili ngarkon në ushtrimin e përkohshëm të detyrës “Kryeinspektor”, *Dega Rajonale Korçë*, punonjës in \*\*\*\*\*, me detyrë “Inspektor”, *Spektori Operacional i Inspektimit të Policisë Pyjore, në Drejtorinë e Inspektoratit të Policisë Pyjore, pranë ISHMPUT, nivel gendror.*
- Urdhri nr.138, datë 17.4.2018, i Kryeinspektorit, i cili ngarkon në ushtrimin e përkohshëm të detyrës “Kryeinspektor”, *Dega Rajonale Dibër*, punonjës in \*\*\*\*\*, me detyrë “Përgjegjës Spektori”, *Spektori Mat, në Sektorin e Policisë Pyjore, Dega Rajonale Dibër.*
- Urdhri nr.27, datë 5.2.2019, i Kryeinspektorit, i cili ngarkon në ushtrimin e përkohshëm të detyrës “Kryeinspektor”, *Dega Rajonale Kukës*, punonjës in \*\*\*\*\*, me detyrë “Përgjegjës Spektori”, *Spektori Kukës, në Sektorin e Policisë Pyjore, Dega Rajonale Kukës.*
- Urdhri nr.312, datë 18.7.2018, i Kryeinspektorit, i cili ngarkon në ushtrimin e përkohshëm të detyrës “Kryeinspektor”, *Dega Rajonale Vlorë*, punonjës in \*\*\*\*\*, me detyrë “Inspektor”, *në Sektorin e Inspektimit Mjedisor, Dega Rajonale Vlorë.*
- Urdhri nr.475, datë 24.12.2018, i Kryeinspektorit, i cili ngarkon në ushtrimin e përkohshëm të detyrës “Kryeinspektor”, *Dega Rajonale Berat*, punonjës in \*\*\*\*\*, me detyrë “Inspektor”, *Spektori Berat, në Sektorin e Policisë Pyjore, Dega Rajonale Berat.*
- Urdhri nr.388, datë 24.10.2018, i Kryeinspektorit, i cili ngarkon në ushtrimin e përkohshëm të detyrës “Kryeinspektor”, *Dega Rajonale Fier*, punonjës in \*\*\*\*\*, me detyrë “Inspektor”, *Spektori Fier, në Sektorin e Policisë Pyjore, Dega Rajonale Fier.*

Departamenti i Administratës Publike, duhet të fillojë menjëherë procedurat për plotësimin e pozicionit të punës “Kryeinspektor”, në Degët Rajonale të ISHMPUT, në bazë të kërkesave të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar.

5. Njësia përgjegjëse për menaxhimin e burimeve njerëzore të institucionit, të përfundojë procedurën e vendimmarrjes në fund të periudhës së provës, për punonjësit \*\*\*\*\* dhe \*\*\*\*\*, duke patur parasysh që të zbatohen të gjitha kërkesat që parashikon ligji për punonjësit në periudhë prove dhe sipas orientimeve në raportin përfundimtar tëmbikëqyrjes.

6. Të kërkoj nga titullari i institucionit, Kryeinspektori i ISHMPUT, të konstatojë pavlefshmërinë absolute dhe të anulojë aktin nr.24, datë 30.1.2017, për transferimin e përkohshëm në kundërshtim me ligjin, të punonjësit \*\*\*\*\*\*, nga pozicioni “*Inspektor i Policisë Pyjore*”, në Degën Rajonale Durrës, në pozicionin “*Inspektor në Sektorin e Inspektimit Mjedisor*”, po në Degën Rajonale Durrës dhe rregullimin e pasojave duke urdhëruar kthimin e tij në vendin e mëparshëm të punës.
7. Të kërkoj nga Ministri i Turizmit dhe Mjedisit, të konstatojë menjëherë, si akt administrative absolutisht të pavlefshëm, aktin nr. 51, datë 27.2.2018, të nxjerrë prej tij, me anë të të cilit, nëpunësi \*\*\*\*\*\*, i cili kryen detyrën Drejtor i Drejtorisë së Prokurimeve dhe Partneriteteve, në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, është ngarkuar për ushtrimin e detyrës si Kryeinspektori Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit dhe të rregullohen pasojat duke urdhëruar rikthimin në pozicionin e tij të punës. Në kushtet kur nga ana e institucionit, pozicioni është shpallur i lirë, Departamenti i Administratës Publike, duhet të vijojë menjëherë procedurat për plotësimin e tij në përputhje me ligjin për nëpunësin civil.
8. Njësia përgjegjëse për menaxhimin e burimeve njerëzore të institucionit, të përfundojë procesin e vlerësimit të rezultateve në punë për vitin 2018 e në vijim, si dhe të ndjekë procesin për të respektuar afatet, sipas orientimeve të dhëna në raportin përfundimtar të mbikëqyrjes.
9. Njësia përgjegjëse për menaxhimin e burimeve njerëzore të institucionit, të plotësojë dosjen e personelit të çdo nëpunësi civil, duke përfshirë në të, të gjitha dokumentet dhe të dhënat sipas lidhjeve 1 e 2, pjesë e Vendimit nr. 117, datë 5.3.2014, të Këshillit të Ministrave, “*Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit*”, si dhe ato të evidentuara në mungesë në tabelënr. 2, e cila është pjesë e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes.
10. Për kryerjen e këtyre veprimeve administrative, lihet afat **60** ditë nga marrja dijeni për këtë vendim. Institucioni i mbikëqyrur dhe njësia përgjegjëse, duhet të zbatojnë këtë vendim duke u bazuar në orientimet e dhëna në përmbajtjen e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes.
11. Me kalimin e këtij afati, subjekti i mbikëqyrur, Inspektorati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, si dhe Departamenti i Administratës Publike, duhet të njoftojnë me shkrim Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me zbatimin e këtij vendimi.
12. Në rast të moszbatimit të këtij vendimi paralajmërues, Komisioneri do të vijojë procesin për rregullimin e shkeljeve të konstatuara, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, duke përdorur mjetet ligjore për

të rikthyer ligjshmërinë në administrimin e shërbimit civil, nëpërmjet gjobitjes së nëpunësit përgjegjës për moszbatimin e masave të përcaktuara në dispozitivin e vendimit.

**13.** Për këtë vendim të njoftohet Inspektorati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit dhe Departamenti i Administratës Publike.

**14.** Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

## **KOMISIONERI**

**Pranvera STRAKOSHA**